

VENDIM
Nr. 717, datë 21.8.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT, SI AUTORITET KONTRAKTUES, PËR VAZHDIMIN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR PROJEKTIN E BURIMEVE UJORE DHE
UJITJES (WATER RESOURCES AND IRRIGATION PROJECT, WRIP-P121186)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013” dhe të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si autoritet kontraktues, për vazhdimin e procedurave të prokurimit të investimeve dhe shërbimeve të konsulencës, në kuadrin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes (WRIP-P121186, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, parashikuar si financim i huaj në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për vitin 2013, me vlerë 496 931 573 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela
 Projekti i burimeve ujore dhe ujitjes
 Water Resources and Irrigation Project
 WRIP-P121186

PLANI I PROKURIMIT PËR VITIN 2013

Kontrata/numri i paketës	Përshkrimi	Planifikuar për t'u disbursuar gjatë vitit 2013 (në lekë)			Komente
		Financim i huaj	TVSH	Kostoja lokale	
INVESTIME					
MAFCP/W/NCB/001	Rehabilitimi i digave në Kukës				Shpallje e tenderit në shtator
MAFCP/W/NCB/002	Rehabilitimi i digave në Berat				Shpallje e tenderit në korrik
MAFCP/W/NCB003	Rehabilitimi i digave në Fier				Lidhja e kontratës në gusht
MAFCP/W/ICB/001	Rehabilitimi i digave në Korçë				Shpallje e tenderit në shtator
MAFCP/W/ICB/002	Rehabilitimi i digës Murriz Thana				Lidhja e kontratës në gusht
WRIP/G/S/001	Pajisje zyre (MBUMK dhe MMPAU)				Shpallje e tenderit në korrik
WRIP/G/S/002	Softi i menaxhimit financiar				Shpallje e tenderit në shtator
SHËRBIME KONSULENCE					
MAFCP/CS/002	Shërbimi i supervizimit për rehabilitimin e digave				Lidhja e kontratës në gusht
MAFCP/CS/003	Studimi i fizibilitetit dhe projekteve të zbatimit për skemat e ujitjes dhe kullimit, konsultime të ndryshme, trajnime dhe mobilizime				Në proces vlerësimi, lidhja e kontratës në dhjetor
MAFCP/CS/006a	Konsulent lokal (inxhinier) – për basenin Drini-Buna				Lidhja e kontratës në nëntor
MAFCP/CS/006b	Konsulent lokal (inxhinier) – për basenin Seman				Lidhja e kontratës në nëntor
MAFCP/CS/011	Përgatitja e strategjisë dhe politikave kombëtare për ujitjen dhe kullimin				Shpallje e tenderit në nëntor
WRIP/CS/QCBS/005	Konsulencë për monitorim dhe vlerësim				Shpallje e tenderit në korrik
		496,931,573	67,358,424	5,000,000	

